



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN DHE NJOFTIMIN ME PUBLIKUN

Nr. 5855 prot

Roskovec, më 11.10.2019

**NJOFTIM**

**Dëgjese Publike për “Hartimin e Rregullores Urbane për Bllokun Nr:2, Qendër, Roskovec”**

Në bazë të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit Nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ju njoftojmë se:

ditën e **Mërkurë**, më datë **16 Tetor 2019**, ora **11:00**, në ambientet e “**Pallatit të Kulturës**” Roskovec, do të organizohet “Dëgjesa publike” në kuadër të “**Hartimit të Rregullores Urbane për Bllokun Nr:2, Qendër, Roskovec**”.

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave, normave dhe standarteve lidhur me përdorimin e tokës, parametrat e zhvillimit dhe elementët e ndryshëm urban, në territorin e Bllokut nr. 2, në qytetin e Roskovecit, Bashkia Roskovec.

Ftojme çdo banorë të komunitetit të Roskovecit dhe të gjithë palët e interesuara të bëhen pjesë e kësaj dëgjese duke garantuar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës!

Për cdo të interesuar i cili kërkon të njihet me materialin mund të paraqitet pranë zyrës së Informacionit të Bashkisë Roskovec.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin!

**KRYETAR**  
Majlinda Bufi

